LIGJ
Nr.8368, datë 9.7 1998

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7665, DATË 21.1.1993 "PËR ZHVILLIMIN E ZONAVE QË KANË PËRPARËSI TURIZMIN"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", neni 4, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Për të mbuluar dhe drejtuar veprimtarinë e turizmit në Shqipëri, krijohet Komiteti për Zhvillimin e Turizmit pranë Këshillit të Ministrave. Kryetari i ketij Komiteti emërohet nga Këshilli i Ministrave.

Për hartimin e politikave dhe për përcaktimin e strategjive të zhvillimit të turizmit në Shqipëri krijohet Këshilli i Politikave të Zhvillimit të Turizmit, i cili funksionon si organ-ndërministror. Përbërja, funksionet, kompetencat dhe organizimi i brendshem i këtij Këshilli caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Këshilli i Politikave të Zhvillimit të Turizmit drejtohet nga zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave."

Neni 2

Në të gjitha nenet e ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", fjalët "Ministria e Turizmit" zëvendësohen me fjalët "Komiteti i Zhvillimit të Turizmit", "Ministri i Turizmit" me fjalet "Kryetari i Komitetit të Zhvillimit të Turizmit" dhe "Komiteti i Zhvillimit të Turizmit" ose "Komiteti" zëvendësohen, përkatësisht, me fjalët "Këshilli i Politikave të Zhvillimit të Turizmit" ose "Këshilli".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin e tij nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2158, datë 20.7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani